



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:278555
Datë: 11.03.2024
Numri i dokumentit: 05432146

ARJ nr.16/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar i kolegjit, Nebojša Boričić dhe Nenad Lazić anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditëses, F.M ..., Komuna S., kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile, në P., me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditëses, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. Nr.283/2023 të datës 27.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 11 mars 2024, merr:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësja, F.M., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit- Departamenti për Çështje Administrative, në Prishtinë, AA. Nr.283/2023 të datës 27.12.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, refuzohet si e pabazuar ankesa e paditëses F.M nga ..., Komuna e S., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr.1923/19 i datës 07.02.2023, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, paditësja, në afat ligjor në Gjykatë Supreme ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, kërkesa të pranohet si e bazuar, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit AA nr. AA. Nr.283/2023, i dt. 27.12.2023, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr.1923/19 i datës 07.02.2023, ashtu që të aprovohet kërkesë padia e paditëses,

të anulohet Vendimi i dt. 17.07.2019 i Departamentit për familjet e dëshmorëve invalidëve të luftës dhe viktimave civile të MPMS, tani Ministria e Financave dhe Transfereve, të vërtetohet se paditësja është përfituese e të drejtës në pension të skemës familjare e viktimave civile, dhe të detyrohet e paditura që ti paguaj në mënyrë retroaktive pagesat për viktimat civile të luftës nga data 10.04.2019 e deri në ditën e ekzekutimit të këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të LKA, ka mbajtur seancën e kolegjit, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe atij të shkallës së parë, sipas theksimeve në kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe shqyrtimit edhe të akteve tjera të lëndës gjen se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me vendimin e organit të paditur, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile në P., të datës 17.07.2019, refuzohet e pa bazuar ankesa e palës ankuese me të cilën ka kërkuar ti njihet e drejta në pension të skemës, familja e viktimave civile, në mungesë të dëshmive përkatëse valide për të përmbushur kriteret për të qen shfrytëzues i pensionit duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-054.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e të paditurës ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit me kërkesë padi që të anulohet si jo i drejtë dhe ligjor dhe këtij ti njihet e drejta në pension, në pension të skemës familje e viktimave civile të luftës. Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin A nr.1923/19, të dt. 07.02.2023, e refuzon kërkesë padinë e paditëses si të pa bazuar me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit përfundimtar të paditurës të dt. 17.07.2019.

Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera arsyeton se, për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të organit të paditur si në kuptim të nenit 44 të LKA i referohet Ligjit 04/L-054, përkatësisht nenit 3 par 1.10, sipas të cilit përcaktohet se, ” *Viktimë civile e luftës- është personi i cili është vrarë apo është plagosur nga forcat e armikut e më vonë ka vdekur brenda periudhës 27.02.1998 deri me 20.06.199,si dhe personat që kanë pësuar si pasojë e luftës brenda tre viteve që nga përfundimi i luftës , nga mjetet e shpërthyesë të mbetura pas përfundimit të luftës”* , në ndërlidhje me këtë nen vlerëson se nga provat e administruara, dhe gjendjes faktike të vërtetuar kërkesa e paditëses nuk mund të aprovohet si e bazuar për realizimin e kësaj të drejte për shkak se nuk ka prova që fëmijët e posa lindur nga paditësja, se janë vrarë apo plagosur nga forcat armike, nuk kanë pësuar nga mjetet shpërthyesë, edhe për kundër që ato kanë lindur në periudhën si parashihet me këtë ligj. Se nga provat e paraqitura nga paditësja vërtetimi i Bashkësisë Lokale dhe vërtetimi nga Nën këshilli i KMDLNJ-S., deklarimet e paditëses në padi dhe seancë të shqyrtimit nuk mund të dëshmohen pretendimet se të njëjtat kanë vdekur si pasojë e mos trajtimit mjekësor apo se i plotëson kushtet për trajtuar viktimat civile të luftës, prandaj vendimet e të paditurës, të dt. 16.05.2017 dhe shkallës së dytë të dt. 17.07.2019, i vlerëson të drejtë dhe ligjor me të cilët është refuzuar ankesa e saj me që nuk ka prova dhe fakte se i plotëson kushtet për t’iu njohur e drejta në pension të skemës familje e viktimave të luftës.

Gjykata e Apelit në procedurë ankimore duke vendosur sipas ankesës së paditëses, si në kuptim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 194 dhe 195.1 pika d) të LPK-së, (ligj i aplikueshëm në kuptim të nenit 63 të LKA-së), merr aktgjykimin e kontestuar me kërkesë, me të cilin e refuzon ankesën si të pa bazuar. Në arsyetim pasi bën përshkrimin e gjendjes faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, dispozitave ligjore procedurale dhe materiale të njëjta, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, lidhur me refuzimin e kërkesë padisë së paditëses. Tutje vlerëson se aktgjykimi ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje procedurale të LKA apo të LPK-së, sipas pretendimeve në ankesë, apo me shkelje tjera që gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK, dhe as me shkelje të drejtës materiale, andaj konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendja faktike dhe juridike, duke iu referuar nenit 3 par.1,pika 10 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK, dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, me që gjykata e shkallës së parë duke bërë interpretim të drejtë të kësaj dispozite sipas gjendjes faktike të vërtetuar me të drejtë vlerëson se sipas provave në shkresa të lëndës rezulton se fëmijët e paditëses nuk janë vrarë apo plagosur nga forcat armike, nuk kanë pësuar nga mjetet shpërthyes ,edhe pse të njëjtat kanë vdekur në periudhën si parashihet me këtë ligj.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, vlerësimin të pretendimeve në kërkesë si më lartë, ekzaminimit të aktgjykimin të kontestuar të Gjykatës së Apelit dhe të shkallës së parë, si dhe shkresave tjera të lëndës vlerëson se, gjykata e shkallës së dytë ka vendosur drejtë dhe në baza ligjore me refuzimin e ankesës së paditëses dhe vërtetimin e aktgjykimin të shkallës së parë. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit por edhe të Gjykatës Themelore në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë nga se nga gjendja faktike e vërtetuar, drejtë kanë zbatuar dispozitat e LKA, të LPK , dispozitat materiale të Ligjit nr.04/L-054 dhe akteve nënligjore të cituara si në aktgjykimet e tyre me refuzimin e kërkesëpadisë së paditëses.

Aktgjykimi i kontestuar i shkallës së dytë nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të së drejtës materiale, ashtu si pretendon në kërkesën e saj paditësjë. Gjithashtu aktgjykimi i shkallës së parë përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, bazuar në provat e administruara dhe vlerësimin të fakteve sipas dispozitave materiale të në të cilat thirret, nga ka rezultuar se e paditura në vendimin e kontestuar të saj me padi me të cilin është refuzuar ankesa e paditëses, në mënyrë të plotë dhe të drejtë i ka vërtetuar faktet vendimtare, andaj ka nxjerrë konkludim të drejtë dhe ligjor, bazuar në dispozitat materiale të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK, dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës, me që paditësjë nuk arrin të argumentoj me prova materiale pretendimet e saj për të dëshmuar se i plotëson kushtet ligjore për t'iu njohur e drejta në pension sipas skemës familje e viktimave civile të luftës.

Pretendimet në arsyetim të kërkesës se gjykatat e instancave më të ulëta nuk i kanë marrë për bazë vërtetimet e Bashkësisë lokale dhe të KMDLN, se fëmijët e saj kanë vdekur si pasojë e keqtrajtimit nga mjekët e nacionalitet tjetër dhe në rrethana lufte, por besimin ja falin vërtetimit tjetër në të cilin nuk shkruan shkaku i vdekjes, etj., në këtë drejtim, kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe vlerëson se nuk janë të qëndrueshme dhe të bazuara

ligjërishit për të vendosur ndryshe në këtë çështje nga ajo e vendosur nga instancat më të ulëta gjyqësore dhe organi i paditur i shkallës së parë dhe të dytë administrativ si në vendimet e tyre. Gjykata e shkallës së parë në seancë të shqyrtimit të provave ka administruar në tërësi provat e ofruara nga paditësja, përgjigjen në padi të paditurës, nga ka rezultuar se pretendimet e paditëses nuk janë të pa bazuara, duke dhënë arsye të mjaftueshme në baza ligjore, me refuzimin e kërkesë padisë së paditëses, sepse pa dyshim janë vërtetuar faktet se në bazë të dokumenteve të prezantuara nga paditësja, nuk provohet me prova konkrete se viktimat e njëjta kanë vdekur pas lindjes së parakohshme si pasojë e kushteve të luftës ashtu si thekon paditësja, andaj nuk janë plotësuar kriteret e kërkuara sipas Ligjit nr.04/L-054, përkatësisht nenit 3 par. 1, pika 10 të tij, të cituar nga gjykatat e instancave më të ulëta, për tu provuar e drejta e kërkuar në baza ligjore. Aktgjykimi i shkallës së dytë është i qartë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme dhe bindëse të dhëna për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet të cilat ekzaminohen sipas detyrës zyrtare, nga ka rezultuar se pretendimet janë të pa bazuara dhe në kundërshtim me provat në shkresa të lëndës të administruara nga gjykata e shkallës së parë. Në këtë çështje e po ashtu e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditëses.

Gjykata nuk shqyrtoi pretendimet e tjera të parashtrueses së kërkesës, lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pasur parasysh se, sipas dispozitës së nenit 24 paragraf 2 të LKA-së, përcaktohet se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes”*.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54 paragraf.1, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME- PRISHTINË
ARJ nr. 16/2024, me datë, 11 Mars 2024

B.Profesionale,
Zanë Buçinca

Kryetari i kolegjit,
Ragip Namani